

THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
PROJEKT PËR EFIKASITET ENERGJETIK NË SEKTORIN PUBLIK
(IBRD 9038MK)
NUMRI IDENTIFIKUES I PROJEKTIT : P149990

MK-MOF-002-2021-CS-CQS

NDIHMË TEKNIKE: ZHVILLIMIN E RAPORTEVE TË DETAJUARA TË AUDITIMIT ENERGJETIK, DIZAJNE TË DETAJUARA ME SPECIFIKA TEKNIKE PËR RENOVIME ME EFIKASITET ENERGJETIK TË NDËRTESAVE DHE AUDITIM TEKNIK

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mori huamarrje nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore për zbatimin e Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik. Qëllimet për zhvillimin e projektit janë: (i) zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorin e komunës; dhe (ii) mbështesin zhvillimin dhe zbatimin e mekanizmit të qëndrueshëm për financim të efikasitetit të energjisë në sektorin publik. Projekti ka për qëllim t’i arrijë këto qëllime përmes mundësimit të investimeve në ndërtesat e qeverisë (qendrore) dhe komunale dhe shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Sipas kushteve të marrëveshjes, projekti ka për qëllim që një pjesë të mjeteve t’i orientojë kah sigurimi i ndihmës teknike për Fondin për zhvillimin e efikasitetit energjetik.

Shërbimet konsulente lidhur me konsulentin përfshijnë: zhvillimin e raporteve të detajuara për kontrollin energjetik, përgatitjen e projekteve të detajuara me specifikime teknike për rikonstruime me efikasitet energjetik të ndërtesave shëndetësore publike në bazë të raporteve të detajuara për kontrollin energjetik, duke përfshirë fazat arkitektonike, ndërtimore, termoteknike, mekanike dhe elektrike, specifikimet teknike, shpenzimet, vlerësimet dhe llogaritjet (BoQs) dhe parashtrimin e revizionit teknik të detajuar të projektit. Gjithashtu, konsulenti do t’i identifikojë rreziqet ekologjike dhe sociale lidhur me punimet e planifikuara të rikonstruimit dhe do të hartojë plane për menaxhim me mjedisin jetësor dhe punët sociale, si dhe listat për kontrollin e tyre. Informacione më të hollësishme në lidhje me kualifikimet e nevojshme mund t’i gjeni në linkun në vijim: https://finance.gov.mk/proekt_za_energetska_efikasnost/.

Shërbimet konsulente janë ndarë në 3 pjesë të posaçme: Lot 1: rajoni i Shkupit, Lot 2: rajoni juglindor, lindor dhe verilindor, Lot 3: rajoni jugperëndimor, i Pelagonisë dhe i Vardarit.

Ministria e Financave u bënë firmave të kualifikuara konsulente (“konsulentë”) që të shprehin interes për sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të dorëzojnë informacione me të cilat do të dëshmojnë se posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Firmat në fjalë, duhet t’i përmbushin këto kritetere:

Përvoja dhe kualifikimet e konsulentit

Konsulenti duhet të jetë kompani konsulente me përvojë relevante projektuese. Puna që duhet ta ndërmerret nga ekipi i konsulentëve i përbërë nga ekspertë, që kanë aftësitë dhe kompetencat e mëposhtme:

1) Kapaciteti ekonomik dhe financiar i konsulentit

Qarkullimi mesatar vjetor i konsulentit duhet të tejkalojë 600.000 euro në 3 vitet e fundit financiare (viti 2018, 2019 dhe 2020)

2) Aftësia profesionale e konsulentit

Kritere për personat juridikë dhe fizikë:

Personi juridik duhet të posedojë licencë të vlefshme për kryerjen e kontrollit energjetik, lëshuar nga Ministria e Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

- Për Lot 1, personi juridik duhet të posedojë licencë A të vlefshme për projektim të kompanisë, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Për Lot 2 dhe 3, personi juridik duhet të posedojë licencë B të vlefshme për projektim të kompanisë, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Të paktën 20 të punësuar të përhershëm që punojnë për konsulentin.

Puna duhet të ndërmerret nga ekipi i konsulentëve i përbërë nga ekspertë me aftësitë dhe kualifikimet e mëposhtme. Ekipi do të përbëhet minimum prej 7 ekspertëve kryesorë të punësuar nga Konsulenti dhe të përkrahur nga ekipi përkrahës i ekspertëve me përvojë dhe të rinj jo kryesorë.

Konsulentët mund të bashkohen me kompani të tjera në formë të investimit të përbashkët ose si nënkonsulentë që të përmirësojnë kualifikimet e tyre. “Shoqëria” mund të jetë në formën e investimit të përbashkët ose shtëpisë nënkonsulente. Në rast të investimit

të përbashkët (IP), të gjithë anëtarë të IP-së do të vlerësohen së bashku për qëllimet e listës së shkurtër dhe do të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për detyrat dhe do ta nënshkruajnë marrëveshjen në rast të ndarjes së investimit të përbashkët (IP).

Konsulentët e interesuar duhet ta shënojnë qartë strukturën e “shoqërisë” së tyre dhe detyrimet e partnerëve dhe nën konsulentëve në aplikimin e tyre. Shprehja e paqartë e interesit sa i përket “në bashkëpunim me” dhe/ose “në lidhje me” dhe ngjashme nuk mund dhe nuk do të merret parasysh për listën e shkurtër. Duke pasur parasysh parimin një shprehje të interesit për kompani, kompania konsulente mund të vendosë nëse dëshiron të merrë pjesë si nënkonsulent ose si konsulent individual ose si partner në investimin e përbashkët (IP).

Ju lutemi, merrni parasysh faktin se kompania do të parashtrojë vetëm një shprehje të interesit në të njëjtin proces të përzgjedhjes ose individualisht si konsulent ose si partner në investimin e përbashkët. Asnjë kompani nuk mund të jetë nënkonsulent derisa të paraqesë shprehje të interesave individualisht ose si partner në investimin e përbashkët (IP) në të njëjtin proces të përzgjedhjes. Kompania, nëse vepron në cilësi të nënkonsulentit ose investimit të përbashkët (IP), mund të merrë pjesë me më shumë se një konsulent, por vetëm në cilësi të nënkonsulentit.

Konsulentët e interesuar duhet të parashtrojnë dokumente të veçanta të shprehjes së interesit, ta identifikojnë në mënyrë të qartë detyrën (Lot) për të cilën janë interesuar që të konkurrojnë. Secila prej 3 detyrave (3 Lota) të lartpërmendura, do të jetë lëndë e marrëveshjes së veçantë dhe prandaj, do të përcaktohen 3 lista të shkurtra për secilën detyrë.

Konsulentët, që janë të interesuar dhe që dëshirojnë të parashtrojnë shprehje të interesit për më shumë se një marrëveshje duhet të vërtetojnë se kanë resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të realizuar më shumë se një marrëveshje të tillë dhe se për çdo marrëveshje të ndryshme, konsulentët në propozimin e tyre duhet të përcaktojnë individë të ndryshëm në ekipet e personelit kryesor.

Informacione shtesë jepen në adresën që është shënuar më poshtë, gjatë orarit të punës prej orës 8:30-16:30, nga e hëna deri të premten.

Shprehja e interesit duhet të dorëzohet në formë të shkruar në adresën që është shënuar më poshtë (personalisht, përmes postës ose e-mail) më së voni deri më **4 shkurt të vitit 2022 në orën 16.30**.

Ministria e Financave
Projekti i efikasitetit të energjisë në sektorin publik
rr. Dame Gruev, nr.12, 1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
Drejtuar z.Aleksandar Najdovski, MSIP - NJZP
Tel/faks: ++ 389 2 3120352
Aleksandar.Najdovski@finance.gov.mk